




Republika e Kosovës



Komuna e Vitisë

PROJEKTI PËR RREGULLIMIN E SHESHIT NË QENDËR TË VITISË



Zyra e Projekteve K.Viti




Komuna e Vitisë



Republika e Kosovës

PROJEKTI PËR RREGULLIMIN E SHESHIT NË QENDËR



Dhjetor , 2019
VITI

Projektoi:
ZYRA E PROJEKTEVE K.VITI

RAPORTI TEKNIK DHE PËRSHKRIMI TEKNIK

Raporti teknik

Hyrje

Në bazë të detyrës projektuese dhe informatave shtesë , në përputhshmëri me kërkesat e klientit (autoriteti kontraktues – K.K. Viti) është vendosur korniza e projektit konform rregullave teknike të aplikueshme dhe duke u mbështetur në normat europiane EC , si dhe në veçanti në normat DIN .

Projekti i sheshit në qytet është trajtuar në mënyrë analitike duke ju referuar rregullave teknike dhe në mënyrë specifike kushteve të kërkuara nga ana e Klientit sipas detyrës projektuese dhe sipas informative shtesë.

Produkti final i këtij projekti infrastrukturor urban është :

-NDËRTIMI I SHESHIT NË QENDËR TË VITISË

Projekti është përpunuar në atë mënyrë që të mund të realizohet si tërësi por edhe si i veçant për çdo detal.

Informatat Bazike

- **DETYRA PROJEKTUESE**

- **NDËRTIMI I SHESHIT NË QENDËR**

- Analiza dhe studimi i gjendjes faktike ne terene (hapsire publike) si dhe vlerësimi i nevojës së vendbanimit për trotuare, ndriçim dhe hapsira gjelbëruese publike.
- Caktimi i gjerësisë së sheshit sipas normave, ndriçimit dhe hapsira gjelbëruese publike EC DIN si dhe parametrave tjerë të nevojshëm për këtë lloj pune.
- Përpilimi i dokumentacionit teknik në nivelin e projektit kryesor detal (ekzekutiv) me të gjitha elementet e nevojshme për këtë lloj projekti. Projekti duhet të mbështetet në metodikën e pranuar si dhe në norma .
- Përpilimi i projektit duhet të bëhet me një software të njohur dhe kompatibil me software që përdoren për përpilimin e të dhënave të përgjithshme .

Projekti duhet t'i nënshtrohet kontrollit të kualitetit intern (nga ana e vet këshilltarit) dhe personi përgjegjës duhet të ketë përvojën e kërkuar në dokumentet e hartimit të projektit , si dhe kontrolli të bëhet vazhdimisht gjatë përpilimit të dokumentacionit.

Përshkrimi i trasesë

Situacioni

Sheshi është I projektuar në vendin ku kalojnë nëpër hapsirën ekzistuese përgjatë rrugëve, vendoset sipas specifikave sipas paraqitjes grafike të projektit Kryesorë.

Ndërtimi i sheshit është projektuar në atë mënyrë që të përshkruajë me lokacionin dhe me të gjitha elementet përcjellëse.

Niveleta

Punimi i niveletës është paraparë të bëhet duke u bazuar në niveletën ekzistuese duke i dhënë rendësi që të ketë sa më pak disnivele të trotuarit me rrugën duke ruajtur gjithnjë nivelin ekzistues.

Profilet tërthore

Distanca maksimale e profileve tërthore është paraparë të jetë max 25 m.

Pjerrtësia tërthore 2.0 %.

Konstruksioni i trotuarit

Shtresat e konstruksionit të trotuarit janë :

Zhavori me fraksion 4-8 mm $t=5.0$ cm

Tamponi prej gurëve të thyer gëlqeror 0-60 mm , $t=20.0$ cm

Tamponi prej gurëve të thyer gëlqerorë 0-31.5 mm , $t=10.0$ cm

Largimi i ujërave sipërfaqësorë

Temperaturat kanë luhetje në varësi të stinëve dhe ato variojnë në dimër deri në -25°C ,dhe stinën e verës deri në $+36.0^{\circ}\text{C}$. Thellësia e ngrirjes përvetësohet 0.60 m'.

Për të gjitha punët ndërtimore duke filluar nga caktimi i vendit për deponi , oazë , stabilizim plotësues të trupit të trotuarit , ngjeshja e nënbazës dhe tampon udhëzimet e organit mbikqyrës janë themelore gjatë ekzekutimit deri në përfundim të projektit .

Përshkrimi teknik

Shënimi i trasesë për gjatë ekzekutimit të punimeve

Për ekzekutimin e punimeve në punishte bëhet së pari përcjellja e shënimeve prej projektit në punishte e të dhënave si shenimi i stacionazhës , lartësive dhe të gjitha elementeve të nevojshme.

Pastrimi i terenit

Largimi i materialit ekzistues - objekteve,asfaltit ekzistues shtyllave ose pengesave tjera prej lokacionit te vendndertimit me qëllim të përshtatjes së me te sakte te projektit ne teren . Cilësia e punimeve duhet t'i plotësojë kushtet si material me kualitet të rezistueshëm ndaj ngricave dhe ngarkesave nga qarkullimi , po ashtu edhe kualiteti I ndërtimit sipas rregulloreve gjermane ZTV për ndërtimin e shtresave mbrojtëse nga ngricat dhe shtresave të pa lidhura mbajtëse.

Kualiteti i kryerjes së punimeve

Cilësia e punimeve duhet të plotësojë kushtet si me material dhe me kualitet të rezistueshëm ndaj ngricave dhe ngarkesave , po ashtu edhe kualiteti I ndërtimit sipas rregulloreve gjermane ZTV për ndërtimin e eshtresave mbrojtëse nga ngricat dhe shtresat e pa lidhura mbajtëse.

Gërmimi i dheut

Gërmimi I dheut të kategorisë së III-të dhe IV- të bëhet sipas projektit për ekzekutimin e punimeve duke i u përshtatur niveletës te projektuar. Dheu i gërmuar largohet deri në deponi në largësi deri 6.0 km largë nga punishtja.

Përgatitja e nënbazës

Pas zhveshjes së humusit bëhet ngjeshja e nënbazës deri në arritjen e aftësisë mbajtëse prej 15 MN/m² . Kontrolli i aftësisë mbajtëse bëhet me pllakë rrethore me diameter 300.0 mm në distance te caktuar nga organi mbikqyres .

Ndërtimi i mbushjes

Materiali për mbushjen e nevojshme në trasen e trotuarit të merret prej huazishtes ose lumit me kualitet DN 1896 dhe struktur zhavori GE apo rërë SE dhe shpërndarje .

$<0.06 \text{ mm} < 5\%$

$>2.0 \text{ mm} >40\%$

$D_{pr} = 95.0 \%$

Përgatitja e plenumit

Para se të shtrihet shtresa dhe ajo stabilizuese bëhet rrafshimi i planumit me saktësi 2.0 cm në distance 4.0 m me ngjeshje deri në arrijen e aftësisë mbajtëse prej 20-25.0 MN/m² . Kontrolli i aftësisë mbajtëse bëhet me pllakë rrethore me diameter 300.00 mm , në distance të caktuar nga organi mbikqyrës.

Ndërtimi i shtresës stabilizuese

Ky material duhet të jetë me cilësi të mira mekanike , material jokoherent , guror i rezistueshëm ndaj ngricave . Shtrimi i kësaj shtrese duhet të bëhet në dy etapa me trashësi 2 herë nga 20.0 cm.

Punimi i shtresës së tamponit prej gurit të thyer gëlqeror 0/63 mm , t=10.0 cm

Materiali prej çakëlli ndërtohet sipër shtresës ekzistuese në konstruksion të trotuarit. Ky material çakëlli prej guri të thyer gëlqeror 0/63 mm, në trashësi prej 20.0 cm me structure të shpërndarë sipas rregullave gjermane ZTV për shtresat mbajtëse të rrugëve . Ky material i sjellur në punishte duhet të ketë përzierje të mire në mes të fraksioneve . Ngjeshja e shtresës së çakëllit duhet të punohet me lagështi optimale sipas metodës së Proktorit $D_{pr}=103.0\%$. Kontrollimi i ngjeshjes së shtresës së çakëllit duhet të kryhet me matjet të modulit të ngjeshjes , sipërfaqja për kontrollim caktohet prej organit të mbikqyrjes me pllakë rrethore 300.0 mm sipas DIN 18134.

Punimi i shtresës së tamponit prej gurit gëlqeror 0-31.5 mm , t=10.0 cm

Sipër shtresës së shtruar prej çakëlli 0/63 në konstruksionin e trotuarit duhet të shtrohet shtresa prej gurit të thyer gëlqeror në fraksion 0/32 , me trashësi 10,0 cm me strukture të shpërndarë sipas rregulloreve gjermane ZTV për shtresat mbajtëse të rrugëve . Ky material i sjellur nga gurishtet në punishte duhet të ketë përzierje të mire në mes të fraksioneve .

Ngjeshja e shtresës së materialit të pa lidhur 0/32 duhet të punohet për lagështinë optimale sipas proktorit $D_{pr} = 100.0\%$. Kontrolli i ngjeshjes së shtresës prej gurit të thyer në fraksion 0/32 duhet të kryhet me matjet e modulit të ngjeshjes . Sipërfaqja për kontrollim caktohet prej organit mbikqyrës , të gjatësisë së trotuarit me pllakë rrethore me diameter 300.0 mm sipas DIN 18134.

Ndërtimi i skajorëve me bazë prej betonit

Sipërfaqja e trotuarit e ndërtuar prej materiali kubzave të betonit në të dy anët anë kufizohet me skajorë të dimensionit 24.0x18.0 (në anën e rruges) paralel me ta në funde të sipërfaqes së shtruar prej kubzave të trotuarit vendosen skajorë me dimensione 20x10.0 cm . Punimi i skajorëve është i paraqitur në detalet e profileve tërthore.Kualiteti i skajorëve duhet të vlerësohet sipas DIN 483 , ndërsa bazamenti i skajorëve prej betony MB15 me kualitet sipas DIN 1045.

Elementet skajorë të trases së rrugës , gurët skajorë , kufizimet .

Konstruksionet e elementeve kufitare të shtresës qarkulluese të trotuarit përfshijnë :

- Furnizimi me elemente përkatëse të parafabrikuara dhe vendosja e tyre ose
- Furnizimi me të gjitha materialet bazë të nevojshme , për përpunimin e tyre dhe vendosjen në njërën anë në vendin e caktuar sipas projektit.

Kjo poashtu përfshinë tërë punën në përgatitjen e themeleve . Ekzekutimi i fugave dhe mbrojtja e nevojshme e sipërfaqeve si dhe poashtu punët në lidhje me përfundimin e këtyre elementeve . Kjo punë duhet të kryhet në kushte klimatike pa të reshura atmosferike ,dhe pa erëra dhe me temperature të bazës prej 5°C deri 25°C .Nëse temperatura është kohë pas kohe më e ulët ose më e lartë , atëherë duhet të ndërmerren masa të posaqme gjatë punimeve . Elementet kufitare nevojiten për mbrojtjen e skajeve të konstruksionit të rrugës dhe për rritjen e sigurisë së trafikut në të gjitha llojet e rrugëve . Lloji i elementeve është zakonisht të caktuara me projekt e nëse jo për masat e marra vendos organi mbikqyrës.

Ndërtimi i kubëzave për Trotuarin

Ndërtimi i kubëzave prej materialit të betonit me trashësi prej 8.0 cm (forma e tyre dhe ngjyra sipas projektit) per trotuarin , me kualitet sipas DIN 18501 dhe DIN 18503 bëhet në bazamentin e përgatitur prej rëre 4/8 ma trashësi 8.0 cm . Pas shtruarjes së kubëzave kryhet ngjeshja e tyre.

Ndërtimi i sipërfaqeve të gjelbëruara

Sipërfaqja e destinuar për gjelbërim parashifet të punohet sipas skicave ne projekt . Ku duhet të mbushet me dhe kualitativ (humus natyror) në trashësi prej 20.0 cm . Rrafshimi dhe mbjellja të bëhet me pëlqimin e organit përcjellës në punishte. Pemët decorative me lartesi 2.5 m të llojit Katallpa ose te ngjajshme. Numri i pemëve decorative sipas projektit kryesorë.

VËREJTJE:

Para fillimit të punimeve duhet që të koordinohen të gjitha fazat e projektit në menyrë që gjatë punimeve të mos ketë mosmarrveshje.

Për të gjitha punimet duhet të aplikohen standardet dhe kualiteti në ISO dhe I ligjeve në fuqi.

Verjetje:Implementimi i punimeve në këtë project duhet të behën në harmoni me ligjet ne fuqi te Republikës së Kosovës, e në rast se ato mungojnë, atehere të aplikohen standardet të BE-së dhe Eurokod-et

6. MBROJTJA NË PUNË, PROGRAMI I KONTROLLËS DHE I SIGURIMIT TË KUALITETIT

6.1 Mbrojtja në punë

Gjatë punimit të këtij dokumentacioni janë marrë zgjidhjet teknike të cilat sigurojnë aplikimin e plotë të rregullave të mbrojtjes në punë, ashtu që të sigurohen kushtet e punës pa rrezik për jetën dhe shëndetin e të gjithë personelit që merrë pjesë në realizimin e ndriçimit dhe më vonë në mirëmbajtjen e tij.

Gjatë aplikimit të rregullave të mbrojtjes në punë, vëmendje të posaqme duhet pasur gjatë fazës së realizimit dhe mirëmbajtjes.

6.2 Masat mbrojtëse në punë gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit të ndriçimit publik

Punëtorët të cilët punojnë në pajisjet elektroenergjetike duhet të jenë të shëndosh fizikisht e psikikisht, si dhe duhet t'u nënshtrohen kontrollimeve të rregullta mjekësore për punë në lartësi. Duhet që jenë të kualifikuar për punën të cilën duhet ta kryejnë, gjithashtu keta punëtorë duhet ti nënshtrohen testimit periodik të diturisë.

Gjatë kohës së punës punëtorët nuk guxojnë të përdorin alkool apo substance tjera të cilat e zvoglojnë aftësin për punë.

Punëtorët janë të obliguar që në mënyrë të saktë, me kohë dhe me kualitet ti kryejnë të gjitha operacionet të cilat u janë dhënë nga udhëheqësi i drejtëpërdrejtë.

Punëtorët në vendin e punës duhet të kenë mbrojtjen e paraparë higjeno-teknike si vijon: helmetën, dorëzat mbrojtëse, qizmet prej gome, kllapat për ngjitje në shtylla apo kamionetën me korpë, rrypat dhe paisjet e tjera të cilat janë të parapara me rregullorën mbi mbrojtjen në punë për këtë lloj veprimtarie.

Pa paisjen e mbrojtjes në punë, punëtori nuk guxon të kryej veprime në vendin e tij të punës, ndërsa për këtë duhet të kujdeset udhëheqësi.

Gjatë ekzekutimit të punëve në stabilimentet me tension, udhëheqësi i punëve duhet të bëjë pregaditjen në atë mënyrë që punëtori i cili ka probleme familjare, psikike etj, të mos dërgohet në punishtë, të ndërmerrën të gjitha masat teknike të sigurisë për punët e programuara, të sigurohet gjendja pa tension etj.

6.3 Sigurimi i gjendjes pa tension

Gjatë ngritjes së shtyllës në afërsi me rrjetin elektrik punët duhet të kryhen në gjendjen pa tension ashtu që ekzekutimi i punëve të jetë i sigurtë nga aspekti i prekjes eventuale të ndonjë mjeti apo pajisje me rrjetin.

6.4 Mbrojtja nga zjarri

Prishjet eventuale si dhe zbrazjet atmosferike mund të shkaktojnë paraqitjen e harkut elektrik, paisjet e ndriçimit publik duhet të jenë të punuara nga materiali zjarrëdurues ku nuk ekziston rreziku i përhapjes së zjarrit në objektet tjera në afërsi të shtyllave ndriçuese apo kuadrit shpërndarës.

6.5 Programi i kontrollës dhe sigurimit të kualitetit

Gjatë realizimit të ndriçimit (furnizimit me material, ndërtim, montim dhe lëshim në punë) bëhen kontrollime, shqyrtime dhe matje të ndryshme me qëllim të vërtetimit të kualitetit të elementeve montuese respektivisht kualitetit të punëve të kryera. Gjatë punimeve kryesi i punëve duhet t'i përmbahet këtij projekti në tërësi.

NORMAT RELEVANTE TEKNIKE DHE STANDARDET QË JANË PËRDORUR NË RASTIN E PËRPILIMIT TË DOKUMENTACIONIT TEKNIK NË KËTË PROJEKT JANË DHËNË MË POSHTË.

6.6 Pranimi i pajisjeve

Të gjitha pajisjet që do të hyjnë në punë në projekt duhet të posedojnë çertifikata dhe ateste të kualitetit në harmoni me rregullat dhe normat:

Llampat ndriçuese

DIN 1048 – Rregullorja për normative teknik për beton IEC Nr. 32, TC-4.6, 1976

Ndriçimi publik i vendeve të posaçme IEC Nr.12/2, TC-4.6, 1975

Ndriçimi i rrugëve me qarkullim motorik IEC Nr.33, TC-4.6, 1976

Mirëmbajta e ndriçimit publik

Në veçanti në fund të projektit duhet të dorzohen:

Raporti mbi matjen e rezistencës së izolimit të kabllove

Raporti mbi matjen e rezistencës së tokëzimit



Rezultatet e shqyrtimit të betonit.

Për shtimin e kualitetit të intevenimit në këtë hapsire publike janë të parapara për t'u vendosur edhe këto elemente:


- Vendosja e ulseve ne pushimoret e parapare me project,
- Vendosja e shportave per hudhjen e mbeturinave (detail sipas projektit),
- Vendosja e mbrojtëseve të pemëve (Sipas projektit)

Pozita e vendosjes së ulëseve dhe shportave do të bëhet në mënyrë egzakthe sipas projektit kryesorë. Dizajni dhe ndërtimi i tyre do të bëhet sipas detaleve të prezantuara në vijim:


Situazioni




Detali i kubzave per nje fushe




Detali i reshates




Detali i shadervanit




Detali gjatësor



Detali tërthori



Detali gjatësor i ulëses



Detali tërthor i ulëses

